



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2023:173665

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05672061

P.nr.91/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sadri Krasniqi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Donjeta Zenuni, dhe bashkëpunëtorin profesional B.S., në çështjen penale kundër të pandehurit Sh. I. nga ....., për shkak të veprës penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1116/2023 të datës 09.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 24.04.2024 në prani të palëve publikisht shpalli, ndërsa më 10.05.2024 hartoi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

**Sh. I.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati N., dhe e ëma M. e lindur I., i lindur më datë ....., në ..... ku edhe jeton me nr. personal ..... Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i pesë fëmijëve, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 14.07.2023, rreth orës 10:00 në ....., i pandehuri nga pakujdesia, me veprimet e tij, me anë të zjarrit, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, duke i shkaktuar dëme të dëmтуarit A.A. në atë mënyrë që i pandehuri, me qëllim të asgjësimit të disa barnojave dhe

pastrimit të oborrit të tij, të njëjtat i ka ndezur, me ç'rast, zjarri ka dalë jashtë kontrollit dhe si pasojë ishte shpërndarë në arën/parcelën e të dëmtuarit, e cila ishte me ushqim bagëtish (sanë e përgaditur për tu lidhur me presë) dhe si pasojë e zjarrit ishte djegur ara/parcela prej 1 hektar pothuajse në tërësi, duke i shkaktuar dëme të vlerë të pa përcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 38, 40, 43, 44, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364 dhe 452, paragrafi 1 të KPPRK-së, të pandehurin Sh.I.e,

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej **300 € (treqind euro)**, të cilën shumë, do ta arkëtoj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet një ditë burg.

Pala e dëmtuar, A.A. nga ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 09.08.2023, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1116/2023, kundër të pandehurit Sh. I., me të dhëna si më lartë për shkak të veprës penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datë 24.04.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Kujtesa Fazilu dhe i pandehuri Sh. I.. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shteti, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë. Andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 6 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tij, se i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht: Raporti fillestar i incidentit me nr të rastit 2023-CB-113 i datës 14.07.2023, deklarata e të dëmtuarit A. A., deklarata e të pandehurit Sh. I., raporti i oficerit policor E. F., raport nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent me nr.serik 00399 i datës 04.07.2023, Njoftimi mbi zjarrin nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent me nr.protokollit 29.2023 i datës 17.07.2023, foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, si dhe shkresat tjera përcjellëse, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Sh.I. nga pakujdesia e ka kryer veprën penale: Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, dhe se është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij ashtu që ka deklaruar se gjithçka ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë pasi që ka pasur erëra të cilat e kanë shpërndarë zjarrin. Gjykata gjithashtu ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit, ku në bazë të dhënave që disponon gjykata shihet se për të pandehurit është hera e parë që bien ndesh ligjin, se i njëjti ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur dhe premtion gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale. Ndërsa gjykata, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese për të pandehurin, andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënim me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit. Bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarin A. A. nga ....., e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarit ti obligojë që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 €(njëzetë euro) si dhe shumën prej nga 20 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit për secilin prej tyre veç e veç, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:173665, 10.05.2024**

Zyrtarja Ligjore,  
Donjeta Zenuni

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Sadri Krasniqi, d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë.